REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

Nr. **Prot** **Bilisht më,** **.** **.2026**

PROJEKT – VENDIM
NR. 60 **, datë,** 16.07**.2026**

"PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL VENDOR TË BASHKISË DEVOLL PËR VITIN 2027-2030"

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 36, të ligjit nr. 121/ 2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", ligjit nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara", ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", të ndryshuar, Ligjit Nr. 11/2026 "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje", vendimit nr. 152 datë 13.03.2024, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale 2024–2030 dhe të planit të veprimit në zbatim të saj", vendimit nr. 111, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe funksionimin e fondit social", të ndryshuar, vendimit nr. 518, datë 04.09.2018, të Këshillit të Ministrave "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar", vendimit nr. 224, datë 09.04.2024, të Këshillit të Ministrave "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, udhëzimit nr. 10, datë 25.2.2015 "Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës" si dhe VKB-së nr 102 datë 26.12.2025 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Devoll".

PROPOZOJ:

1. Miratimin e Planit Social Vendor, 2027-2030, për Bashkinë Devoll, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij projekvendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit, Sektori i Planifikimit të Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar.

Konceptoi: Përgj. i sektorit të Kujdesit Social dhe PAK
Marilda Bejleri
Miratoi: Drejtor i Shërbimeve Sociale
Zerina Sinani
Konfirmoi bazën ligjore: Përgj. i sektorit Juridik dhe i prokurimeve
Eriksela Avdo
Konfirmoi: Sekretar i Përgjithshëm
Adriana Rushitaj

KRYETARI I BASHKISË

EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DEVOLL

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

Nr. 2825 **Prot** **Bilisht më,** 16.07.**2026**

RELACION
Për projekt-vendimin

"PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL VENDOR TË BASHKISË DEVOLL PËR VITIN 2027-2030"

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 36, të ligjit nr. 121/ 2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", ligjit nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara", ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", të ndryshuar, Ligjit Nr. 11/2026 "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje", vendimit nr. 152 datë 13.03.2024, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale 2024–2030 dhe të planit të veprimit në zbatim të saj", vendimit nr. 111, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe funksionimin e fondit social", të ndryshuar, vendimit nr. 518, datë 04.09.2018, të Këshillit të Ministrave "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar", vendimit nr. 224, datë 09.04.2024, të Këshillit të Ministrave "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, udhëzimit nr. 10, datë 25.2.2015 "Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës" si dhe VKB-së nr 102 datë 26.12.2025 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Devoll".

Ky dokument ka për qëllim të sigurojë zhvillimin e politikave lokale në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror të cilat burojnë nga politikat dhe standartet kombëtare për mbrojtjen shoqërore, të formuluara në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale, 2024-2030, e cila pasqyron angazhimet e Qeverisë Shqiptare në fushën e Mbrojtjes Sociale duke synuar që t'i sigurojë çdo qytetari shqiptar pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike e fetare, shërbime publike cilësore dhe barazinë e plotë para ligjit.Miratimin e Planit Kombetar te Veprimit per Barazi, Perfshirjen dhe pjesmarrjen e Romeve dhe Egjiptianeve ne Republiken e Shqiperise (2026-2023). Plani Kombetar I Veprimit per personat me aftesi te kufizuara.(2026-2030)

Hartimi i Planit Social nga njësia e qeverisjes vendore është një detyrim që rrjedh nga neni 36 i Ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë". Paketa bazë e shërbimeve të kujdesit shoqëror që rrjedh nga ligji i sipërcituar i vjen në ndihmë bashkisë në procesin e planifikimit të shërbimeve sipas nevojave për mbrojtje dhe përkujdesje ndaj grupeve vulnerabël. Kjo paketë shërbimesh është konsoliduar përmes Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar". Nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror identifikohen nga Bashkia përmes proceseve konsultuese dhe ato harmonizohen në Planin Social lokal, por shërbimet mund të ofrohen drejtpërdrejtë nga një ofrues publik (Bashkia, Qarku apo SHSSH) ose nga ofrues jopublikë. Bashkia duhet të drejtojë jo vetëm procesin e identifikimit të nevojave, por edhe koordinimin e kontributeve që mund të vijnë nga aktorë të ndryshëm publik e jopublik dhe reflektimin e tyre në këtë Plan.

Nëpërmjet këtij plani, Bashkia Devoll do të garantojë shërbime të kujdesit shoqëror me cilësi të lartë në bashkëpunim me OJF-të dhe sektorin privat për të përmirësuar jetën e fëmijëve dhe të të rriturve, të përjashtuar dhe/ose në rrezik përjashtimi, duke siguruar mbrojtjen, përfshirjen dhe integrimin shoqëror të tyre.
Plani Social i Bashkisë Devoll përgjatë realizimit të misionit do të ndihmojë në:

- ✓ Rritjen e përgjegjësive të pushtetit lokal për të mundësuar, mbështetur, mbrojtur dhe garantuar realizimin e të drejtave sociale të qytetarëve të bashkisë Devoll, në radhë të parë, të atyre më të përjashtuar dhe në rrezik përjashtimi;
- ✓ Forcimin e kapaciteteve institucionale që ofrojnë shërbime të integruara dhe të veçanta për individë dhe grupe në nevojë kritike, si në komunitet ashtu dhe në familje;
- ✓ Sigurimin e bashkërendimit dhe bashkëpunimit midis qeverisë qendrore, pushtetit vendor dhe rrjetit të organizatave jofitimprurëse;
- ✓ Fuqizimin e institucioneve të pushtetit vendor, sidomos në drejtim të identifikimit të personave "në nevojë" ose "të rrezikuar" si dhe të vendimmarrjes mbështetur në parimin e interesit më të mirë të qytetarit dhe të respektimit të të drejtave sociale;
- ✓ Zbatimin e praktikave të mira dhe të modeleve të përparuara të financimit të shërbimeve sociale;
- ✓ Përdorimin me efektivitet të Fondit Social Vendor dhe përcaktimin e proceseve që garantojnë përdorimin e tij;
- ✓ Zgjerimin e rrjetit të bashkëpunëtorëve, në drejtim të përfshirjes dhe fuqizimit të bashkëpunimit me partnerë tradicionalë dhe jo tradicionale, duke synuar interesin më të mirë të qytetarit;
- ✓ Vëzhgimin/mbikqyrjen e zbatimit të standardeve të miratuara të shërbimeve sociale, pavarësisht nga format dhe tipologjitë e shërbimeve.

Qëllimi Strategjik: Të sigurohet mbrojtje dhe mbështetje e specializuar për grupet më të përjashtuara, me synim përmirësimin e mirëqenies, autonomisë dhe përfshirjes së tyre sociale, nëpërmjet zhvillimit të një sistemi të qëndrueshëm të shërbimeve të kujdesit social, që garanton akses të barabartë në shërbime sociale të integruara dhe cilësore në familje, në komunitet dhe në situata emergjence.

Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social me bazë familjen dhe komunitetin për grupet në nevojë, nëpërmjet ndërtimit dhe funksionimit të modelit të

shërbimeve në familje për të moshuar, fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara, si dhe familje në varfëri.

Objektivi Strategjik 2: Forcimi i mekanizmave vendorë të mbrojtjes emergjente dhe kujdesit social për personat në situata rreziku, nëpërmjet ndërtimit dhe funksionimit të një strehëze për persona në nevojë emergjente.

Në përputhje me pikat 2 dhe 3 të nenit 36 të Ligjit 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror pranë bashkive ngrihen struktura të posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe pranë çdo njësie administrative, në varësi të bashkisë, ngrihet njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit.

Në çdo njësi administrative në varësi të bashkisë, me përjashtim të bashkive me më pak së 6 mijë banorë, ngrihet Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit e cila, në këndvështrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, duhet të ketë këto detyra kryesore:

a) Identifikimin e rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë.

b) Vlerësimin fillestar të nevojave dhe të riskut për individët në nevojë.

c) Informimin dhe këshillimin publik mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, këshillim për punësim, informim për pagesat sociale në të holla.

ç) Hartimin e planit individual të përkujdesit dhe mbështetjes.

d) Bashkërendimin e mbështetjes për individët e familjet në nevojë, si dhe referimin te shërbimet e kujdesit social në nivel vendor, rajonal e qendror, sipas fushës së përgjegjësisë dhe mundësisë për ta ofruar shërbimin e nevojshëm.

dh) Përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për çdo individ për të përfituar nga shërbimet komunitare apo shërbimi rezidencial që përmbush nevojat e individit.

e) Mbikëqyrjen në vazhdimësi të ecurisë së rasteve, si dhe vlerësimin për përshtatshmërinë e shërbimit të ofruar.

ë) Hedhjen në Regjistrin Elektronik Kombëtar të të dhënave përkatëse për njësinë administrative në varësi të bashkisë, sipas përcaktimit të Nenit 29, pika 2 të Ligjit 121/2016.

f) Aplikimin për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.

Për të realizuar funksionet e përcaktuara, Njësia për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimit, duhet të ketë të paktën:

a) një punonjës social të vlerësimit dhe referimit të rastit për çdo 6 000 deri në 10 000 banorë;

b) një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve për çdo 3 000 fëmijë;

c) administrator shoqërorë.

Me urdher me Nr.279 date.29.06.2026 eshte ngritur edhe NJVNR prane Bashkise Devoll.

Përgjatë viteve 2027-2030 ky plan social do këtë dy prioritete kryesore:

1.Ndërtim dhe funksionim i modelit të shërbimeve në familje për: Të moshuar, Fëmijë dhe të Rritur AK, Të varfër.

2.Ndërtim dhe funksionim i një strehëze për persona në nevojë emergjente: Të moshuar, Fëmijë në nevojë për mbrojtje, Gra në nevojë për mbrojtje.

Risia në këtë plan social për Bashkinë Devoll do të jetë sigurimi i mbrojtjes dhe shërbimeve bazë jetësore për fëmijë të huaj të mitur të pashoqëruar, prane Pikes Kufitare Kapshtice.

Përfundimisht, ky dokument do ti shërbejë të gjithë qytetareve të Bashkisë Devoll që i përkasin kategorive të mësipërme duke nxitur pjesëmarrjen qytetare, aktivizimin e tyre në jeten publike dhe respektimin e të drejtave të tyre duke nxitur zhvillimin e demokracisë dhe respektimin e mëtejshem të të drejtave qytetare.

Ju faleminderit!

Konceptoi: Përgjegjes i Kujdesi Social dhe PAK
Marilda Bejleri
Miratoi: Drejtor i Shërbimeve Shoqërore
Zerina Sinani